



## Organizata “Përtej Barrierave”

### Thirrje për Ekspertë

## Hartimi i Studimit Kombëtar mbi Punën Rinore “Dimensione Rinore – Potenciali dhe Zhvillimi i Punes Rinore ne Shqiperi”

### Termet e Referencës

---

*Përtej Barrierave është një organizatë jofitimprurëse e shoqërisë civile, e themeluar në vitin 2004. Ne punojmë me të rinjtë në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian, duke promovuar përfshirjen dhe ngritjen e kapaciteteve përmes edukimit joformal. Përtej Barrierave është Pika e Kontaktit e programeve Erasmus+ YiA dhe European Solidarity Corps të Komisionit Evropian, për Shqipërinë.*

#### Mbi Projektin

Puna rinore në Shqipëri është në një udhëkryq me shumë sfida, siç janë institucionalizimi dhe njohja, zhvillimi i mëtejshëm, klasifikimi në fusha interesi dhe specializimi i punonjësve që punojnë me të rinjtë, mungesa e të dhënave cilësore në fushë, apo dhe aspekte të promovimit dhe vlerave që ajo mbart.

Edhe pse me një nga popullsitë më të reja në moshë në të gjithë Europën, në Shqipëri edukimi i të rinjve mbetet brenda kornizës së edukimit formal, brenda mureve të shkollës. Megjithëse vitet e fundit ka pasur një përmirësim të sektorit rinor përse i përket fuqizimit të organizatave rinore dhe qëndrueshmërisë së tyre, sërisht jemi ende larg përfshirjes së të rinjve në aktivitete rinore, sidomos atyre në zona e rajone më të margjinalizuara.

Duke punuar prej vitesh me edukimin dhe gjithëpërfshirjen e të rinjve me disavantazhe, e shohim si një nevojë të menjëhershme sjelljen e një qasje të re, e cila synon të mos “luftojë” më për ti sjellë të rinjtë tek organizatat por tu shkojë atyre aty ku janë e t’ua dërgojë aktivitetet në mjedisit e tyre të zakonshme, në qytetet dhe fshatrat ku ata jetojnë, në mjedisit e shkollave ku ata mësojnë.

#### Studimi Kombëtar mbi Punën Rinore

Hartezimi dhe mbledhja e të dhënave do të kontribuojnë në kuptimin mbarëkombëtar, eksplorimin dhe zhvillimin e sektorit të punës me të rinjtë në Shqipëri. Ky proces do të trajtojë komponentë të ndryshëm si fusha tematike dhe praktika e punës me të rinjtë, cilësia e punës me të rinjtë, mënyra sesi edukohen dhe trajnohen punëtorët rinorë, implikimet për cilësinë dhe qëndrueshmërinë e punës me të rinjtë. Të dhënat e mbledhura të këtij hulumtimi do të përdoren për të zhvilluar diskutime, përgjigje, sugjerime për zgjidhje alternative dhe mbështetjen e nevojshme me aktorë të ndryshëm duke përdorur qasjen ndërsektoriale



KONGRESI  
RINOR  
KOMBËTAR





### **Qëllimet e Studimit**

- Mbledhje e të dhënave cilësore dhe sasiore mbi punën rinore në Shqipëri përmes një studimi të thelluar në 12 qarqe të vendit;
- Identifikimi i tendencave të përbashkëta dhe pasqyra e gjendjes së sektorit të punës me të rinjtë në Shqipëri;
- Demonstrimi i vlerës së punës rinore dhe rëndësisë kritike të punonjesve rinorë për zhvillimin e të rinjve dhe komuniteteve.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Eksperti me mbështetjen e organizatës do të ketë detyrat e mëposhtme:

- Përgatitja e metodologjisë që do të ndiqet për studimin
- Përcaktimi i burimeve dhe mjeteve të nevojshme për të kryer studimin (burimet njerëzore, materiale, logjistike dhe financiare).
- Mbajtjen e kontakteve dhe koordinimin me skuadrën e realizimit të studimit
- Përfshirja e profesionistëve dhe palëve të interesit që do të ofrojnë opinionin e tyre gjatë draftimit të studimit.

### **Kriteret për aplikim**

- Diplomë Master Shkencor në Punë Sociale, Administrim dhe Politika Sociale, Shkenca Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Studime Europiane dhe fusha të tjera të lidhura
- Së paku 3 vite eksperiencë në çështje dhe projekte rinore
- Eksperiencë në sektorin e shoqërisë civile
- Përvojë me koordinimin e veprimeve për realizimin e studimeve, raporteve në sektorin e shoqërisë civile
- Njohuri shumë të mira të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 dhe të Ligjit të Rinisë.

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim**

- Jetëshkrim (CV)
- Letër interesi
- Ofertën Financiare

### **Afatet kohore për realizimin e studimit:**

Dorëzim i metodologjisë	25 Shkurt 2023
Dorëzim i draftit të parë të studimit	20 Mars 2023
Dorëzim i dokumentit final të studimit	15 Prill 2023



**KONGRESI  
RINOR  
KOMBËTAR**





## Procedura e Vlerësimit

Zgjedhja e personit do të bazohet në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në termat e referencës, gjithashtu edhe bazuar në tabelën e vlerësimit të mëposhtëm.

Kriteret e vlerësimit:

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në %
Kualifikime	30%
Eksperiencë Pune	50%
Oferta Financiare	20%

*Subjektet e interesuara duhet të dërgojnë çdo aplikim brenda datës 15 Shkurt 2023, në adresën elektronike: [office@beyondbarriers.org](mailto:office@beyondbarriers.org) dhe cc [jon.kola@beyondbarriers.org](mailto:jon.kola@beyondbarriers.org)*

\*Ju lutem konsideroni që vetëm kandidatët fitues do të kontaktohen.



KONGRESI  
RINOR  
KOMBËTAR

